



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 327/26 Dt. 20.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

- Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Projekt Planit Komunal për Energji dhe Klimë për Komunën e Prizrenit (PKEK). Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
 - Islam Ukaj,.....kryesues,
 - Adem Morina,anëtar,
 - Levent Bus,anëtar,
 - Emine Gashi,anëtare,
 - Përparim Shala,anëtar,
 - Gëzim Gërgi,anëtar, koordinator .
- Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij vendimi, është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Projekt Planin Komunal për Energji dhe Klimë për Komunën e Prizrenit, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe pas hartimit të draftit përkatës, ti procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.
- Grupi Punues i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, Projekt Planin Komunal për Energji dhe Klimë për Komunën e Prizrenit, do ta hartoj në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës e në mbështetje nga GIZ.
- Obligohet kryesuesi, koordinatori dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Grupit Punues,
 - Asociacionit të Komunave të Kosovës,
 - GIZ-it,
 - Arkivës së Kryetarit.

